

DEKRET
Nr.7439, datë 1.12.1990

PËR BANKËN E SHTETIT SHQIPTAR PËR MARRËDHËNIET ME JASHTË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Krijohet Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë si institucion shtetëror në sistemin bankar të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 2

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë ka këto të drejta e detyra:

a) Merr pjesë në veprimtaritë dhe në marrëveshjet me karakter ekonomik e financiar që organizata ekonomike e financiare të shtetit shqiptar, zhvillojnë e përfundojnë me organizata të huaja ekonomike e financiare.

b) Vendos marrëdhënie dhe lidh marrëveshje bankare me bankat e huaja për çeljen dhe mbajtjen e llogarive në klering, me kompensim ose në valutë të lirë, si dhe mba depozita të bankave të huaja dhe depozita të saj pranë tyre. Gjithashtu ajo mban llogari në valutë të personave juridikë e fizikë të huaj dhe shtetas shqiptarë.

c) Përqëndron llogaritë e arkëtimeve e të pagesave në valutë të huaj dhe monedhë kombëtare të institucioneve, ndërmarrjeve e organizatave dhe kryen arkëtimet e pagesat në valutë të huaj për veprimet e eksport-importit dhe për veprimet e tyre me karakter jotregtar, duke zbatuar format e pagesave më të përshtatshme.

ç) Kryen këmbime valutore për nevojat e vete dhe të klientëve të saj brenda dhe jashtë shtetit.

d) Tregëton tituj me vlerë në valutë të huaj dhe dokumente tregtare e financiare, duke përdorur format më të përshtatshme të arkëtimit të pagesës.

dh) Ndihmon klientët e saj në veprimtarinë e eksport-importit.

e) Ushtron kontroll për ligjshmërinë e përdorimit të fondeve në valutë nga institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat e ndryshme.

ë) Përpunon dhe paraqet të dhënat e duhura për hartimin e planit të të ardhurave dhe të shpenzimeve në valutë.

f) Lëshon dhe pranon garanci bankare në bazë të kritereve të caktuara me dispozita të veçanta.

g) Bën vetë, ose në bashkëpunim me organet e tjera shtetërore analiza e studime për zhvillimin e eksport-importit dhe rritjen e të ardhurave në valutë.

gj) Për shërbimet që kryen Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, mban komisione e shpenzime në valutë ose monedhë kombëtare, sipas natyrës së veprimit, në bazë të tarifave konkurruese përkatëse të miratuara prej saj.

Neni 3

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë jep kredi në monedhë kombëtare dhe në valutë me afatet e kushtet që përcaktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Për investimet që krediton, Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë shqyrton e

kontrollon studimet, projektet e preventivat dhe miraton dhënien e kredisë, në bazë të treguesve të laverdisshmërisë ekonomike. Ajo ndjek dhe kontrollon kryerjen e punimeve, vënien në shfrytëzim në afat të objekteve dhe realizimin e treguesve të efektivitetit deri në shlyerjen e kredisë.

Kur Banka vëren shkelje të rregullave ose shmangie nga qëllimi a destinacioni i kredisë, ajo pezullon ose ndërpret kreiditimin kërkon kthimin para afatit të kredisë dhe urdhëron ndërprerjen e punimeve, duke njoftuar organet përkatëse.

Nëse kredia nuk kthehet në afat ose nuk garantohet me vlera materiale, Banka ndërpret a kufizon dhënien e kredisë, ose kërkon kthimin e menjëherëshëm të saj. Për kreditë e pakthyera në afat zbatohet interes më i lartë se për kreditë e rregullta.

Neni 5

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet e Jashtë është person juridik me qendër në Tiranë ka rrjetin e saj në rrethe, varet nga Këshilli i Ministrave dhe përgjigjet e jep llogari para tij. Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, për kryerjen e detyrave, ka aparatin e saj.

Drejtori i Përgjithshëm drejton Bankën dhe përgjigjet për tërë veprimtaritë e saj, e përfaqëson atë ose autorizon të tjerë që ta përfaqësojnë.

Neni 6

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë mund të çelë degë ose përfaqësi jashtë shtetit.

Neni 7

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë krijohet Këshilli i Bankës, si organ këshillmor që kryesohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili miraton edhe përbërjen e këtij këshilli.

Neni 8

Degët e Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë të rretheve varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë e japin llogari para saj, si dhe para komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Neni 9

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë ka këto fonde:

- a) Fondin e themelimit prej 600 milionë lekësh.
- b) Fondin rezervë prej 200 milionë lekësh.
- c) Fondin e mjeteve kryesore.

Neni 10

Shteti garanton të gjitha detyrimet e Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, që rrjedhin nga veprimet e kryera në bazë të këtij dekreti.

Neni 11

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë organizohet sipas parimit me llogari më vete. Pesëdhjetë për qind e së ardhurës neto të planifikuar dhe tridhjetë për qind e saj mbi plan derdhen në buxhetin e shtetit. Pjesa tjetër përdoret për fuqizimin e fondeve të Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, për investime etj., sipas kriterëve të caktuara me dispozita të veçanta.

Bilanci vjetor i Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 12

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë mban sekret të gjitha marrëdhëniet me klientët e saj në lidhje me depozitat e llogaritë e tyre dhe me veprimet që bëhen për to.

Neni 13

Ministritë e institucionet e tjera qendrore, ndërmarrjet dhe organizatat, me kërkesë të Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, i paraqesin kësaj plani financiare, bilancet dhe çdo të dhënë tjetër për të bërë studime, analiza e kontrole me karakter ekonomik e financiar, që të rritet efektiviteti i fondeve valutore.

Neni 14

Drejtoria e Përgjithshme e Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, në bazë dhe për zbatim të dispozitave të këtij dekreti dhe të dispozitave të Këshillit të Ministrave, jep udhëzime që janë të detyrueshme për ministritë e institucionet e tjera qendrore, organet e tyre vartëse dhe organizatat.

Neni 15

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë ka vulën e saj me shenjat e stemës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Neni 16

Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI SIHAT TOZAJ	KRYETARI RAMIZ ALIA
---------------------------------	-------------------------------